

Të jetosh me pak para

Kostoja e jetesës në Zvicër është mjaft e shtrenjtë. Kjo është arsyeja pse mund të jetë e dobishme të blini disa gjëra të dorës së dytë (tashmë të përdorura). Njerëzit që kanë pak para mund të marrin ndihmë financiare. Ata mund të blejnë në dyqane me çmime më të ulëta.

Mbështetja shtetërore

Në përgjithësi, njerëzit që jetojnë me pak para kanë të drejtë për ndihmë shtetërore. Është e mundur të merrni ndihmë subvencione) për primet e sigurimit shëndetësor ose bursa studimi. Në disa situata, dikush merr para nga sigurimet shoqërore ose ndihma sociale.

Mbështetja e Shoqatave

Disa shoqata ndihmojnë njerëzit në vështirësi financiare.

Për shembull: Caritas Jura, Kryqi i Kuq (Croix-Rouge), Secours d'hiver, Mimosa Jura ose Armée du Salut.

Mbështetja e tyre merr formë të ndryshme: për shembull, informacion, këshilla, ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ose oferta ushqimore.

Merrni ndihmë lehtësisht nëpërmjet JU-lien.org

Në faqen e internetit JU-lien.org, mund të gjeni mbështetjen financiare që ekziston në Jura. Kjo faqe interneti ofron gjithashtu një shërbim informacioni falas dhe konfidencial. Në internet ose nëpërmjet telefonit (079 677 37 65), mund të keni një konsultë falas dhe konfidenciale me një profesionist.

Artikuj të dorës së dytë (ose të përdorur)

COMM9 nga Caritas ofron artikuj të dorës së dytë, me kosto të ulët.

Këto janë gjëra të përdorura më parë, por në gjendje të mirë.

Ka dyqane COMM9 në Delémont, Porrentruy dhe Saignelégier.

Në internet dhe në rrjetet sociale, ka edhe artikuj të dorës së dytë.

Dyqanet ushqimore të Solidaritetit

Njerëzit me pak të ardhura mund të blejnë në dyqanet ushqimore të solidaritetit. Ata mund të blejnë ushqime dhe gjëra të nevojshme për jetën e përditshme me çmime të lira.

Për ta bërë këtë, ata duhet të regjistrohen direkt në shoqatat e mëposhtme: « Les cartons du cœur », « Table couvre-toi » dhe « Au P'tit plus ». Jo të gjithë kanë të drejtë të shkojnë në dyqanet ushqimore të solidaritetit.

Duhet të plotësojnë disa kushte.

Karta e kulturës: sport / kulturë / arsim

Me CarteCulture (Karta e Kulturës), njerëzit që jetojnë me pak të ardhura mund të marrin çmime më të lira për ngjarje sportive, kulturore dhe trajnime.

Për të marrë Kartën duhet të pyesni Caritas-in.

Caritas ofron të gjitha informacionet e nevojshme.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/parat-dhe-tatimet/te-jetosh-me-pak-para